



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME LEZHË SH.A

Shtojca 13

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[Data:19/11/2024]

Drejtuar: “**HASTOÇI**” shpk

Adresa: Tiranë, Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Pjeter Bogdani, Pallati nr.17, Apartamenti 5/3, perball Kopshtit nr.31

NIPT J62028009B

Procedura e prokurimit/lotit: **E hapur, me mjete elektronike (punë)**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-21131-09-23-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “**Rikonstruksion i rrjetit te fshatit Dajç, Njesia Administrative Dajç, Bashkia Lezhe**”, me fond **107,094,913** (njqind e shtate milion e nentedhete e kater mije e nenteqind e trembedhete) lekë pa TVSH, me burim financimi nga Buxheti i “Shtetit”, në përputhje me sasitë, specifikimet teknike, termat e referencës dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Objekti i prokurimit do të prokurohet, kontraktohet dhe zbatohet (lëvrohet) brenda afatit të lëvrimit. Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto X

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

- **Bashkimi i operatorëve ekonomik ”Shoqëria “B93 II” shpk me NIPT L522090500**, rruga "Margarita Tutulani", Pallati Kaso , Kati 7-t, Ap.76, Njesia Bashkiake Nr.5, Tiranë,

“B-93” shpk me NIPT J62903508R rruga “Andon Doro” lagja 8 shkurti, Fier, me vlerë të ofertuar 94,028,290.43 (nentedhjetë e kater milion e njezet e tete mijë e dyqind e nentedhjetë pike dyzet e tre) Lekë pa TVSH, me çmime të paraqitura sipas shtojcës 1.

- **Bashkimi i operatorëve ekonomik ”JUNIK” sh.p.k me NIPT J68007522L** - me adresë: Lagjja SMT, Ndertese 2-Kateshe, kati 2, prane Drejtorise Sherbimit Pyjor Lezhe, **"SHPRESA-AL" sh.p.k me NIPT K31321021N** Rruga ”Urani Pano”pas Qendrës VEVE,Pall.11 katësh,Kati 2, zyra nr.1 Tiranë, me vlerë të ofertuar 96,138,806.17 (nëntëdhjetë e gjashtë million e tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e gjashtë pikë shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH, me çmime të paraqitura sipas shtojcës 1.
- Operatori ekonomik **“HASTOÇI” shpk me NIPT J62028009B**, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total 100,500,506.03(Njëqind milion e pesëqind mijë e pesëqind e gjashtë,pikë zero tre) Lekë pa TVSH, me çmime të paraqitura sipas shtojcës 1.

* * *

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik ”Shoqëria “B93 II” shpk me NIPT L522090500 dhe “B-93” shpk me NIPT J62903508R nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit publik, pasi:

- Formulari ofertes ekonomike e paraqitur nga ky bashkim operatoresh është me gabim ne llogaritje, duke qënë se mbëshetetur në preventivin e publikuar nga Autoriteti Kontraktor për këtë procedure prokurimi, punimet per kete objekt kane dhe makineri –pajsje te cilat nuk rriffen me tvsh.
- Nga llogaritja e Komisionit të Vleresimit te ofertave rezultoj se ne vleren pa tvsh të paraqitur nuk ka mbledhur ne llogaritje vleren e makineri paisje. Ndodhur ne keto kushte, Komisioni i Vleresimit te Ofertave vlereson se ofertave e paraqitur nga bashkimi I opertaoreve ekonomik është e pavlefshme.

Ne vijim te shqyrtimit te dokumenatcionit duke qene se ky bashkim opertaoresh mbetet I skualifikuar, Komisioni per shkak te economicitetit proceddural nuk vijon me mangesi te tjera,te cilat nuk e ndryshojne statusin juridik te bashkimit te operatoreve ekonomik.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës

4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”,

2.3 Kapaciteti teknik:

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

Për matësat e ujit

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhena të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë ose deklaratë nga prodhuesi / distributori i autorizuar që vërteton se standarti i prodhimit të matesave të ujit është sipas OIML R49 / ekuivalente me të, sipas rekomandimeve të Organizatës Internacionale të Metrologjisë Ligjore.
- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatën e aprovimit sipas MID /ekuivalente me të, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9875 datë 14.02.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 datë 21.01.2010, Ligjin Nr. 14/2013 dhe Ligjin Nr. 100/2015.

***Ky operator ekonomik skualifikohet!**

2. Bashkimi i operatorëve ekonomik "JUNIK" sh.p.k me NIPT J68007522L &"SHPRESA-AL" sh.p.k me NIPT K31321021N, nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit publik, pasi:

Shoqëria "SHPRESA-AL" Tirane, Shqiperi 0,65 (zero pike gjashtedhjetë e pesë) %

Konkretisht, Shoqëria "SHPRESA-AL" shpk, do të perballojë financimin në masën e % së dhënë duke përfshirë kapacitetin ekonomik, tekniko-profesional dhe stafin inxhinierik-profesional të kërkuar në DST.

Konkretisht, Shoqëria "SHPRESA-AL" shpk do të mbulojë këto zera:

NR. 6 , Kodi 3.158/5 Transport dheu me auto deri në 5.0 km

NR.8 , Kodi 2.37/3a Transport materiale ndertimi , dheu me auto deri në 3.0 km .

Bashkëlidhur Preventivi Oferte i Bashkëpunimit.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria "Junik"

sh.p.k. si përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterit të sipërcituar si më poshtë vijon:

- Shoqëria "SHPRESA-AL" sh.p.k. ka paraqitur licencën me kodin III.2.B me emërtim përshkrues të veprimtarisë "*Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe dherave*".

Në nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".

Në nenin 92 të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar me , parashikohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar me Vkm Nr.498 date 1.2024, neni 39, pika 6, parashikohet si më poshtë: "Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës .

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se mungon Licensa III.2.B. Operoret nuk e plotesojne kete kriter pasi të dy operoret kane marre punime sipas ndarjes ne preventive, me zera punimesh te cilat krijojne mbetje te ndryshme e si rrjedhoj te dy duhet te jene te pajisur me licensen III2B. Kjo license i mungon shoqërisë “Junik” sh.p.k Mbështetur në VKM-ne Nr. 285/2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, Neni 88 pika 3, parashikohet se: Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbushe kerkesat te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kerkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet ti permbushen nga i gjithë bashkimi, ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne aktmarreveshje."

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Bashkimi i operoreve ekonomik, bazuar ne prokuren dhe ndarjen e punimeve , rezulton se secili prej anetareve te ketij bashkimi kane mare persiper te realizojne punime te cilat eshte e nevojshme pajisja me Licensa III.2.B. si e tille mungesa e Licences III.2.B , nga anetaret e tjere te Joint Venture sjell mangesi ne dokumenta dhe mospermbushje te kriterit nga ky BOE. Dokumentat teknike, ekonomike, dhe profesionale duhet te permbushen nga i gjithë bashkimi i operoreve ekonomik ne raport me % e bashkepunimit te marre persiper. Ne rastin konkret Operatori ekonomik "Junik" sh.p.k nuk ka paraqitur licensen III.2.B te kerkuar ne dokumentat standarte te tenderit.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktor referuar dokumentacive standarte të tenderit.

Lidhur me marreveshjen e bashkëpunimit të paraqitur nga subjektet e mesiperme në marreveshje të perbashkët bien dakort për:

KONTRIBUTI

Kërkesat për kualifikimin ligjor, ekonomik, profesional dhe ato teknike, do të përmbushen nga i gjithë bashkimi i shoqërive, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në këto punë të përcaktuara më poshtë.

Volumi i ngarkesës që do të përballojë secila Shoqëri në realizimin e tenderit do të jetë si më poshtë:

Shoqëria "Junik" sh.p.k., Tirane, Shqipëri 99,35 (nëntë dhjetë e nëntë pike tridhjetë e pesë) % - Lider.

Shoqëria Junik shpk do të përballojë financimin në masën në % të dhënë duke përfshirë kapacitetin ekonomik, tekniko-profesional dhe stafin inxhinierik-profesional të kërkuar në DST. Shoqëria Junik shpk do të mbulojë të gjithë zërat e Preventivit përveç atyre të poshtëshënuar që i mbulon SHPRESA-AL shpk. Bashkëlidhur Preventivi Oferte i Bashkëpunimit.

Shoqëria "SHPRESA-AL" Tirane, Shqipëri 0,65 (zero pike gjashtëdhjetë e pesë) %

Konkretisht, Shoqëria "SHPRESA-AL" shpk, do të përballojë financimin në masën e % të dhënë duke përfshirë kapacitetin ekonomik, tekniko-profesional dhe stafin inxhinierik-profesional të kërkuar në DST.

Konkretisht, Shoqëria "SHPRESA-AL" shpk do të mbulojë këto zëra:

NR. 6 , Kodi 3.158/5 Transport dheu me auto deri në 5.0 km

NR.8 , Kodi 2.37/3a Transport materiale ndertimi , dheu me auto deri në 3.0 km .

Bashkëlidhur Preventivi Oferte i Bashkëpunimit.

DETYRIMET E PALËVE

Keto shërbime mbulohen nga shoqëria "SHPRESA-AL" sh.p.k. e cila referuar Kontrates së Bashkëpunimit ka marrë përsipër realizimin 100% të zërit të punimeve "Transport material ndertimi, dheu me auto deri në 3.0 km" dhe "Transport dheu me auto deri në 5.0 km", për të cilën është e domosdoshme pajisja me licencën QKL Kodi .III.2.B.

Komisioni i vlerësimit të ofertave, sqaron se, në kontratën e bashkëpunimit referuar edhe ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, operatorët ekonomikë anëtarë të një bashkimi nuk ndajnë kapacitetet teknike, ekonomike e ligjore, se cilën prej këtyre kapaciteteve do të plotësojë secili prej anëtarëve, pasi plotësimi i tyre do të bëhet në përpjesëtim me përqindjen e përcaktuar në kontratë si dhe me zërat përkatës sipas elementëve konkretë të përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit, duhet të përmbushen në përputhje me përqindjen dhe elementët konkretë të marrë përsipër nga secili anëtar i këtij bashkimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë rezultojnë se licenca III.2.B është paraqitur vetëm nga operatori ekonomik "SHPRESA-AL" sh.p.k., ndërkohë që nuk është paraqitur asnjë licencë e tillë nga "Junik" sh.p.k.

Për më tepër që, nga verifikimi i kontratës së bashkëpunimit të këtyre dy operatorëve ekonomikë rezultojnë se në ndarjen e përqindjes dhe elementëve konkretë që do të ketë në ngarkim secili anëtar i këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, secili prej tyre ka marrë përsipër zëra që përfshijnë

grumbullimin, transportimin dhe depozitimimin e mbetjeve, pasi licenca III.2.B nuk përfshin vetëm transportin, sipas të cilit është një element/ zë të cilin e ka marrë përsipër për ta kryer shoqëria “SHPRESA-AL” sh.p.k., por përfshin edhe elementë të tjerë si grumbullimi dhe depozitimi, elementë/zëra këto që janë marrë përsipër nga operatori ekonomik anëtarë të këtij bashkimi, gjë e cila detyron që secili operator ekonomik anëtar i këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, duhet të disponojë një licencë të tillë në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Në nenin 88, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik per këtë procedure prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe legjislacionit në fuqi dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se, bashkimi i operatorëve ekonomikë "SHPRESA-AL" sh.p.k. & "Junik" sh.p.k nuk e përmbush kriterin e përcaktuar në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt vlerësimi, pasi nuk është paraqitur licenca e kategorisë III.2.B "Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte" nga të gjithë anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë sipas përqindjes së marrë përsipër nga secili në kontratën e bashkëpunimit.

Referuar vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.100/2020, per raste te ngjashme te vleresimit te pikes se licenses.

Gjithashtu ne vijim te vlerësimit, Komisioni I Vlerësimit te ofertave mbështetur në kërkasat e AK për këtë procedure prokurimi konkretisht;

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B "Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte"

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se operatori ekonomik, pjese bashkimit te operateve si ofertues per kete procedure prokurimi, në licencen e paraqitur nuk ploteson kerkesen e AK, duke qënë se emërtimi i licenses se paraqitur eshte "Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe dherave" dhe jo "Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte", ashtu sikurse eshte kerkuar nga AK ne dokumentat standarte te tenderit, duke mos plotesuar keshtu kerketat e AK per kete pike te kriterave te vecanta te kualifikimit.

Ndodhur ne keto kushte bashkimi i operateve ekonomik mbete i skualifikuar duke mos plotesuar kerketat e AK.

Në vijim të kërkesave të Autoritetit Kontraktor ,konkretisht pika 2.3.2

a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 "*Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi*", i ndryshuar.

Licenca e paraqitur nga operatori ekonomik "Junik" shpk rezulton se është e pavlefshme gjate periudhës së zhvillimit të procedurës , duke marr si referncë datën e hapjes së tenderit, konkretisht licence është e vlefshme deri me date 05.09.2024.

***Ky operator ekonomik skualifikohet!**

3. Operatori ekonomik “**HASTOÇI**” shpk me NIPT **J62028009B**, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total 100,500,506.03(Njëqind milion e pesëqind mijë e pesëqind e gjashtë,pikë zero tre) Lekë pa TVSH,

Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit

Në plotësim të kriterëve të vecanta të kualifikimit për këtë procedurë si dhe asaj teknik, operatori ekonomik ka paraqitur nje grafik punimesh me një afat prej 10 (dhjetë) muajsh, duke pasqyruar në mënyrë të qartë dhe argumentuar dhe organizimin e shoqërisë për përmbushjen me sukses të realizimit të punimeve për periudhën e propozuar prej 10 (dhjetë) muajsh.

Referuar propozimit të operatorit ekonomik peshës specifike të dhënë nga AK për secilën nga pikat, operatori ekonomik vlerësohet si më poshtë:

Stafi / Organizimi i Kompanisë

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave , konstaton se, është paraqitur dokumentacion në lidhje me stafin e nevojshëm të kërkuar në dokumentat e tenderit, atë kryesor dhe mbështetës, për të gjitha specialitetet dhe profilet e kërkuara duke u shoqëruar me licencat profesionale në zbatim në ndërtim, CV-të, kontratat e punës, diplomat, dokumentacion ky i paraqitur sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, nëpërmjet të cilave evidentohen qartë profesionet, kualifikimet, profilet e punës, dhe eksperiencat e mëparshme të realizuara prej tyre.

Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social

Komisioni i vlerësimit të ofertave mbështetur në dokumentacionn e paraqitur në SPE nga OE, konkretisht Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social , vlerëson se OE ka propozuar një raport të mirë për planveprimi të ndikimit në mjedis dhe atij social për zonën për'rreth në të cilët do të kryhen punimet, duke propozuar për masat konkrete që do të marr gjatë zbatimit të punimeve.Operatori ekonomik ka përcaktuar dhe përshkruar masa të përgjithshme që do të ndërmarin gjatë ndërtimit për minimizimin e ndikimit në mjedis në zonën ku do të zhvillohet objekti.

Gjithashtu, kanë hartuar masa për menaxhimin mjedisor, masa për menaxhimin e mbetjeve etj. Nga ofertuesit janë paraqitur propozime për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës që do të ndërmarren gjatë implementimit të projektit.

Periudha e garancisë së objektit

Mbështetur në deklaratën e garancisë së paraqitur nga OE, në të cilën ky operator jep një garanci prej 26 muajsh të punimeve të kryera.

Pikët e marra në total për operatorin ekonomik janë: 280, 65 pikë

Sa më lart, referuar nenit 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor ka vendosur të pranojë ofertën e Operatorit Ekonomik Shoqëria “HASTOÇI” sh.p.k, dhe të kualifikojë si ofertë të vlefshme ofertën e paraqitur prej tij.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “HASTOÇI” shpk** me **NIPT J62028009B** dhe adrese Rruga Pjetër Bogdani, Pallati nr.17, Apartamenti 5/3 përballë Kopshtit Nr.31 Njësia Nr.5, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 100,500,506.03 (Njëqind milion e pesëqind mijë e pesëqind e gjashtë, pikë zero tre) Lekë pa TVSH /pikët totale të marra **280, 65 pikë** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë sh.a, adresa Lagjja "Nene Tereza", Rruga Bajram Curri, Ndertese 2-Kateshe ne zonen kadastrale nr.8632, numri i pasurise 1/130, Lezhë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, **brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.**

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Adresa :Lagjja "Nene Tereza", Rruga Bajram Curri, Ndertese 2-Kateshe ne zonen kadastrale nr.8632, numri i pasurise 1/130, Lezhë.